



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 19.07.2024

Nr: 3

Ora: 14:00

**VENDIM**

**PËR**

**MIRATIMIN E DISA KARAKTERISTIKAVE TEKNIKE TË FLETËS SË VOTIMIT  
PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË HIMARË, TË DATËS  
4 GUSHT 2024**

Në mbështetje të dekretit të Presidentit nr. 244, datë 5.7.2024, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Himarë” dhe nenit 20 pika 1, shkronja “g”, nenit 97, pikat 2 e 3/1 dhe nenit 98 pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e disa karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Në varësi të subjekteve zgjedhore që do të regjistrohen brenda afatit ligjor, mund të ndryshohen përmasat e fletës së votimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.



4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

<b>Ilijana NANO</b>	<b>Kryetar</b>	<b>Pro</b>
<b>Arens ÇELA</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Pro</b>
<b>Dritan ÇAKA</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Pro</b>
<b>Helga VUKAJ</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Kundër</b>
<b>Muharrem ÇAKAJ</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Kundër</b>

***Shënim:***

*Në zbatim të pikës 3, të nenit 20, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, akti nuk mori numrin e kërkuar të votave për t’u konsideruar i miratuar.*

**Disa karakteristika të fletës së votimit për kandidatët për Kryetar Bashkie për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024**

**Lloji i letrës:**

Letër me thurje (Watermark) jo më pak se 90gr/m<sup>2</sup> 100% pulp, me fibra karboni ultraviolet, 2 shtresa, me certifikatë origjine, me mikroprintime, elementë në printim që shikohet me rreze ultraviolet.

**Dimensionet e fletës së votimit:**

Gjerësia e fletës së votimit jo më e vogël se 210 mm  
Gjatësia e fletës së votimit jo më e vogël se 297 mm

**Orientimi i fletës së votimit:**

Portret

**Specifikime të përgjithshme:**

Stema e Republikës, me ngjyra.

Logo KQZ, me ngjyra.

Ngjyra e fletës së votimit: kod i ngjyrës:

PANTONE 7401 U

**Barkodi (elementë të fshehur teknikë në formën e kodeve):**

- Numri serial 7 shifra
- Qarku 2 shifra
- Bashkia 2 shifra
- Zona e administrimit zgjedhor 2 shifra
- Numri i qendrës së votimit 6 shifra dhe elementin ndarës “/” ndërmjet katër shifrave të para dhe dy shifrave të fundit

**Elementë teknikë të lexueshëm në fletën e votimit**

Zona Zgjedhore

Qendra e votimit